

Rruga drejt së vërtetës 34



Fillimisht ju ftojme të ndiqni ajetin **103** të sures **Bekare**:

"E sikur të kishin besuar ata dhe sikur të ishin ruajtur (prej mëkateve), po të dinin, shpërblimi prej All-llahut do të ishte shumë më i dobishëm"

Në emisionin e kaluar thamë se populli jehud në vend që të mbështetet tek Teurati dhe librat e tjerë Qiellorë, shkoi pas librave që kishin të bëjnë me magjinë dhe për të justifikuar këtë sjellje, hz. Sulejmanin a.s. e cilësuan si burim të magjisë në kohën kur Kur'ani e ka mohuar këtë pretendim të tyre duke e prezantuar hz. Sulejman a.s. të pastër nga këto akuza. Ky ajet thekson se nëse jehudët do të kishin besim të pastër dhe do t'u largoheshin këtyre punëve dhe pretendimeve të kota, do të ishte më mirë për ta, sepse besimi i vetëm nuk mjafton, por nevojitet edhe devotshmëria dhe kujdes. Devotshmëria nuk është me kuptimin e heqjes dorë nga punët e këqija, por është një gjendje dhe fuqi e brendshme e cila njeriun e pengon nga punët e këqija si gënjeshtria dhe atë e inkurajon për punë të mira si namazi.

Tani, të ndjekim ajetin **104** të sures **Bekare**:

**"O ju që keni besuar, mos thuani: Raina - po thuani: Undhurna dhe respektoni!
Mosbesimtarët kanë dënim të dhembshëm"**

Muslimanët e periudhës së fillimit të Islamit, kur Profeti Muhammed s.a.v.s. mbante ndonjë fjalim apo atyre u lexonte ajete nga Kur'ani, ata për të kuptuar më mirë fjalët e Profetit kërkonin që ai të flasë në atë nivel që ata të mund të kuptojnë ato fjalë. Muslimanët këtë kërkesë e parashtronin duke thënë "Raina" që në gjuhën arabe do të thotë "kujdesu për ne" ndërsa në gjuhën jehude kjo fjalë është me kuptimin çmendurisë dhe jehuditë kur dëgjonin këtë talleshin me muslimanët duke ju thënë se ju kërkonin nga Profeti juaj që t'ju bëjë të çmendur. Për këtë arsye zbriti ky ajet që i porositi muslimanët që në vend të fjalës "Raina" të thonë "Undhurna" në mënyrë që armiku të mos mund të abuzojë dhe të tallet me besimtarët. Zakonisht është mirë që njeriu të heqë dorë nga çdo vepër e cila armikut i jep pretekst, qoftë në fjalë apo qoftë në sjellje. Ky ajet gjithashtu tregon se feja Islame i kushton rëndësi zgjedhjes së fjalëve të mira dhe respektit gjatë bisedës me të mëdhenjtë dhe mësuesit duke u ndaluar atyre çdo vepër që bëhet shkak për talljen apo fyerjen e vlerave të shenjta islame nga ana e armiqve.

Tani, të ndjekim ajetin **105** të sures **Bekare**:

"As ata, ithtarët e librit që nuk besuan, e as idhujtarët nuk duan që juve të ju vijë ndonjë e mirë nga Zoti juaj. Mirëpo, All-llahu me mëshirën e vet veçon atë që dëshiron, All-llahu është Zot i mirësisë së madhe"

Ky ajet flet për kulmin e urrejtjes së idhujtarëve ndaj muslimanëve në mënyrë që idhujtarët, nga xhelozia dhe inati, nuk mund të durojnë që muslimanët të kenë libër Qiellor dhe të Dërguar nga

Zoti dhe me këto mirësi të luftojnë devijimet dhe trillimet e "ithtarëve të librit". Zoti i Plotfuqishëm në këtë ajet thekson se Ai, me Madhështinë e Tij e zgjedh si të dërguar atë që dëshiron dhe nuk plotëson dëshirat e dikujt që i dërguari, duhet të jetë nga ky fis apo nga ai fis, ose nga kjo racë apo nga ajo racë.

Tani, do të ndjekim ajetin 106 të sures Bekare:

"Ne nuk abrogojmë (pezullojmë) asnjë nga argumentet tona, apo ta hedhim në harresë e të mos sjellim edhe më të dobishëm se ai, ose të ngjashëm me te. A nuk e ke ditur se All-llahu është i plotfuqishëm për çdo send?"

Në fillim, kibleja e muslimanëve ishte drejt Bejtul Mukaddesit, mirëpo pasiqë jehudët këtë e shfrytëzonin si pretekst duke u thënë muslimanëve se ju nuk keni një fe të ndarë dhe i drejtoheni kibles tonë, me urdhër të Zotit, kibleja e muslimanëve nga Bejtul Mukaddesi ndryshoi në drejtim të Mekkes. Tani, jehudët sollën një pretekst tjetër duke thënë: Nëse kibleja e parë ishte e drejtë atëherë pse e ndryshuat atë, e nëse kibleja e dytë është e drejtë, atëherë çfarë do të bëhet me veprat tuaja të mëparshme?! Kur'ani famëlartë, në përgjigje të këtyre preteksteve thotë: Ne nuk pezullojmë asnjë vendim apo ta vonojmë atë vetëm nëse sjellim më të mirë se ai ose të ngjashëm me të. Ndryshimi i kibles apo vonesa në shpalljen e Qabes si kible të muslimanëve ka shkaqe dhe arsye të ndryshme të cilat ju nuk i dini.

Duke patur parasysh që vendimet islame nuk janë pa mirësi dhe dobi, me ndryshimin e kohës, vendit apo kushteve, ndryshojnë edhe mirësitë dhe dobitë e çështjeve dhe kështu ndodh që një vendim i mëhershëm pezullohet dhe zëvendësohet me një vendim të ri. Nuk ka dyshim që vendimet Hyjnore janë stabile dhe të pandryshueshme por në disa hollësi dhe në veçanti në çështjet e pushtetit, ndryshime të këtilla janë të pranueshme. Ky ajet na bën të qartë se në Islam nuk ka qorrrokak, sepse kjo është një fe botërore dhe e përjetshme. Përkrah ligjeve dhe rregullave të pandryshueshme mund të ekzistojnë edhe ligje të ndryshueshme duke u bazuar në nevojën dhe interesin e islamit.

Tani, le të ndjekim ajetin 107 të sures **Bekare**:

"A nuk e ke ditur se vetëm All-llahut i takon sundimi i qiejve e i tokës, dhe se pos All-llahut nuk keni as mbrojtës as ndihmëtar"

Pas ajetit të mëparshëm që fliste për pezullimin e disa vendimeve Hyjnore, ky ajet thekson se ata të cilët reagojnë ndaj ndryshimit të urdhrave, e kanë harruar sundimin absolut të Zotit! A kanë harruar ata se Zoti është Sundues i çdo gjëje që ekziston në këtë gjithësi në këtë mes edhe i njeriut dhe ka të drejtë që të ndryshojë apo pezullojë çdo ligj apo vendim duke u bazuar në mirësinë e Tij të pafund. Për fat të keq, populli beni izraelit kishte përfytyrim të gabuar në lidhje me fuqinë absolute të Zotit duke e cilësuar si të kufizuar këtë fuqi, në kohën kur Zoti është i lirë dhe vepron në bazë të dijes së Vet absolute si në krijim, ashtu edhe në vendosjen apo ndryshimin e ligjeve dhe rregullave.

Nga këto ajete mësojmë se:

1- Besimi nuk mjafton i vetëm, por nevojitet edhe devotshmëri dhe kujdes në mënyrë që të mbrohet besimi nga dëmtimi dhe rreziku.

2- Armiku po ndjek me vëmendje çdo lëvizje madje edhe fjalët tona dhe ne duhet të largohemi nga çdo lëvizje dhe fjalë të cilat armiqtë mund t'i shfrytëzojnë kundër Islamit dhe muslimanëve.

3- Armiqtë e Islamit dëshirojnë që çdo zhvillim dhe progres të jetë monopol i tyre duke mos dashur që ju besimtarë të përfitoni nga ndonjë e mirë dhe begati. Atëherë, pse ne duhet të ulemi dhe presim mëshirën e tyre duke patur mundësinë që t'i mbështetemi vetëm Zotit të Gjithëdijshëm ?

4- Shpallja, ndryshimi apo pezullimi i vendimeve është vetëm në dorë të Zotit dhe në bazë të nevojave të njerëzimit dhe urtësisë së Tij, Zoti merr vendime për të ndryshuar apo anuluar një ligj apo rregull.

Marre nga: <http://albanian.irib.ir>